

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN PORTËZ, FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në komunën Portëz, aktualisht njësia Administrative Bashkisë Fier, me objekt:“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.06.2013 deri më 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 107, datë 20.09.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 565/7, datë 25.09.2015, i ka rekomanduar z. Armand Subashi, Kryetar i Bashkisë Fier, në të cilën përfshihet njësia Administrative Portëz, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetjet nga auditimi: Nga stafi drejtues nuk njihen komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin (MKF-së) duke mos gjetur zbatim në të gjitha hallkat e tij. Mungon hartimi i planit strategjik për ngritjen e sistemit të MFK dhe menaxhimit e riskut, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe të UMF nr 30, datë 27.10.2011 për MFK .

Rekomandim:Bashkia Fier (në të cilën përfshihet Komuna Portëz nga shkrirja e NJQV)), të marrë masa për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues i ligjit të MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin e një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

2. Gjetjet nga auditimi: Nuk është hartuar dhe miratuar Rregullorja e funksionimit të brendshëm të administratës, ku të jenë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për çdo pozicion, që nga niveli drejtues e deri tek niveli më i ulët i punonjësve për çdo sektor. Të përfshihet zbatimi i parimeve të kodit etik, rastet dhe rregullat për t’u zbatuar për shmangien e konfliktit të interesit, treguesit e performancës, instrumentet monitorues dhe rregullat e komunikimit dhe për raportimin e aktivitetit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar neni 32/ç dhe ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” .

Rekomandim: Bashkia Fier (në të cilën përfshihet Komuna Portëz nga shkrirja e NJQV)), të marrë masa për hartimin e rregullores së funksionimit të brendshëm në përputhje me strukturën organike, duke implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Kodin Etik.

3. Gjetjet nga auditimi: Nga puna e pamjaftueshme e administratës taksave të ish-Komunës Portëz, janë debitorë për taksat vendore në vlerën **7,526,000 lekë**, nga të cilat vlera 1,550,000 lekë detyrim i Bizneseve private dhe vlera 5,976,000 lekë, detyrim i papaguar nga fermerët për taksën e tokës bujqësore që kanë në pronësi.

Rekomandim: Bashkia Fier (në të cilën përfshihet Komuna Portëz nga shkrirja e NJQV)), të marrë masa për arkëtimin e debitorëve për taksat vendore në vlerën **7,526,000 lekë**, nga të cilat vlera 1,550,000 lekë detyrim i Bizneseve private dhe vlera 5,976,000 lekë, detyrim i papaguar nga fermerët për taksën e tokës bujqësore që kanë në pronësi.

4. Gjetje nga auditimi:Nuk ka një evidencë të saktë të inventarit të pyjeve apo kullotave të Komunës Portëz, pasi ka mosrakordim të kufijve territorial me Komunën Cakran, Komunën Qendër dhe Bashkinë Patos. Lidhur me këtë fakt, pronat me numër rendor 6,9,12-15,18,21-25,36-37,46-48,52,56-59,65-66 është mbajtur akt rakordimi nr. 41,datë 26.01.2012 midis Komunës Portëz dhe Komunës Cakran, për përcaktimin e kufijve administrativë të secilës Komunë, bazuar në VKM nr.1648, datë 17.12.2008 ndryshuar me VKM nr.901,datë 21.12.2011.

4.1.Rekomandim:Bashkia Fier(në të cilën përfshihet Komuna Portëz si njësi administrative), të marrë masa duke ngritur grup pune, për rishikimin e aktrakordimeve nr.42, datë

26.01.2012 dhe nr.55, datë 27.01.2012 në përputhje me VKM nr.1648, datë 17.12.2008 ndryshuar me VKM nr.901, datë 21.12.2011, ku të përcaktohet lista përfundimtare e pronave të paluajtshme.

5. Gjetjet nga auditimit: Nuk është hartuar dhe zbatuar asnjë plan menaxhimi e mbarështimi në pyje kullota livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve. Ky mosveprim vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar dhe me VKM nr. 22, datë 9.01.2008, “Për Përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 3, 4 e në vijim.

-Nuk është kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor, me synim evidencimin e përditësimit e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimësi, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës) shtrirë në territorin e juridiksionit të kësaj Komune. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 5 “Planin e Mbarështimit”, nenin 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, nenin 15, pika 2 “Pronësia e Fondit Pyjor” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

- Mungon evidentimi, administrimi i bilancimit të fondit kullor, mosveprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, neni 5, pika 2 germa “b”, “Pronësia”, neni 7, “Inventarizimi”, neni 8, “Regjistrimi”, neni 9, “Regjistri i Fondit Kullor”, neni 14, “Planin e Mbarështimit” dhe neni 15, “Bimët Mjekësore”.

Rekomandim: Bashkia Fier (në të cilën përfshihet Komuna Portëz si njësi administrative), të marrë masat për hartimin e planit të menaxhimit e mbarështimi në pyje, kullota e livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore, si bimësi të ndryshme, dhënien me qira të pronave të veta etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.

6. Gjetjet nga auditimi: Nuk janë marrë masat e nevojshme për menaxhimin dhe mbrojtjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore:

Nuk strukturën organike të komunës, nga viti 2014 e në vazhdim, nuk është parashikuar punonjës për mbrojtjen e tyre;

Nuk është përpiluar dhe miratuar plan i ri i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave; në kundërshtim me kërkesat e nenin 5, 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, neni 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar dhe pika 5/dh e VKM nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”.

Rekomandimi:

Bashkia Fier (në të cilën përfshihet Komuna Portëz si njësi administrative), të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor, të hartojë planin e mbarështimit dhe ruajtjen e sipërfaqeve pyje dhe kullota.

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në germa “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Fier (në të cilën përfshihet Komuna Portëz si njësi administrative), fillimin e procedurave administrative për dhënien e masës disiplinore, nga “Vërejtje”, për këta persona:

1. **z.A.Ç**, me detyrë përgjegjës i Zyrës së Taksave

2. **z. A.M**, me detyrë Inspektor Terreni, në Zyrën Taksave

3. **z. A.A**, me detyrë Inspektor Terreni, në Zyrën e Taksave

Për punë të pamjaftueshme në lidhje me arkëtimin e taksave vendore, për pasojë janë debitorë për taksat vendore në vlerën **7,526,000 lekë**, nga të cilat vlera **1,550,000 lekë** detyrim i Bizneseve private dhe vlera **5,976,000 lekë**, detyrim i papaguar nga fermerët për taksën e tokës bujqësore që kanë në pronësi.

4. z. F.Z, me detyrë Përgjegjësi i Zyrës së Kadastrës

Për arsye se:

-Nuk ka hartuar dhe nuk ka zbatuar asnjë plan menaxhimi e mbarështimi në pyje kullota livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve. Ky mosveprim vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, *“Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”*, të ndryshuar dhe me VKM nr. 22, datë 9.01.2008, *“Për Përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”*, pikat 3, 4 e në vijim.

-Nuk është kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor me synim evidencimin e përditësimit e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës) shtrirë në territorin e juridiksionit të kësaj Komune. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 5 *“Planet e Mbarështimit”*, nenin 6 *“Funksionimin e Shërbimit Pyjor”*, nenin 15, pika 2 *“Pronësia e Fondit Pyjor”* të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, *“Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”*, të ndryshuar, dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

-Nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrim dhe bilancimit të fondit kullosor, mosveprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 *“Për Fondin Kullosor”*, neni 5, pika 2 germa “b”, *“Pronësia”*, neni 7, *“Inventarizimi”*, neni 8, *“Regjistrimi”*, neni 9, *“Regjistri i Fondit Kullosor”*, neni 14, *“Planet e Mbarështimit”* dhe neni 15, *“Bimët Mjekësore”*.

C. VLERËSIM I CILËSISË Së AUDITIMIT

Auditimi i kryer në komunën Portëz, njësi administrative e Bashkisë Fier, vlerësohet si auditim i dobët, pasi nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat e programit të auditimit, në këto kushte ky subjekt do të riauditohet për pika të veçanta, nga ana e institucionit tonë në një kohë tjetër të përshtatshme.

Nga Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia Administrative Portëz (ish komuna), është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Pirro Bregaj, Marvin Karalli, dhe Taulant Dervishaj, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT